

LAJMËRIM

Bazuar në V.K.M-në Nr. 780 datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” të ndryshuar studentët e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” dhe “Master Profesional” përfitojnë reduktim deri me 50 % të tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2025 – 2026, pasi plotësojnë kriteret e pikave të VKM-së si më poshtë:

1/a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, studentë që nuk shikojnë (Verbër)/tetraplegjikë/paraplegjikë/me aftësi të kufizuara

- a. Fotokopje të noterizuar të Vërtetimit të K.M.C.A.P-së (Komisionit të caktimit të aftësisë për punë)
- b. Vërtetimi original nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë që merr studenti
- c. Fotokopje e kartës së identitetit të studentit

1/a) Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

- a. Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCA-së (Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) për studentin me prindër me aftësi të kufizuara (invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik);
- b. Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës së bashku me fotokopjen me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës të përfituar sipas statusit të invalidit të punës;
- c. Vërtetim original të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit;
- d. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar **numrin e dosjes** dhe të jetë shënuar qartë **shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë)**, si dhe **masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme)**. Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga përgjegjësi i seksionit të ndihmës ekonomike dhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vetëtime me korrigjime të pa firmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura;
- e. Certifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës/invalidin paraplegjik/tetraplegjik
- f. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit dhe të prindit invalid

1/b Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore,

- a. Certifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me kryefamiljarin familja e të cilit përfiton ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- b. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar **numrin e dosjes** dhe të jetë shënuar qartë **shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë)**, si dhe **masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme)**. Vërtetimi duhet të jetë me numër protokolli, të jetë nënshkruar nga përgjegjësi i seksionit të ndihmës ekonomike dhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. Nuk pranohen vetëtime me korrigjime të pa firmosura nga personat përgjegjës dhe të pavulosura.
- c. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit

1/b) studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

- a. Certifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b. Certifikatë vdekjeje e prindit që u është ndarë nga jeta;
- c. **Vërtetime që vërtetojnë të ardhurat vjetore të familjes, si më poshtë:**
 1. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që familja përfiton ndihmë ekonomike si familje në nevojë
 2. Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që asnjë nga familjarët e studentit (personat mbi 18 vjeç) nuk ushtrojnë aktivitet privat;
 3. Vërtetime nëse prindërit apo ndonjë pjesëtar i familjes mbi 18 vjeç janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë (nga zyra e punës);
 4. Vërtetim familjarisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (nëse përfitojnë pension ose jo).

1/c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

- a) Certifikatë Familjare;
- b) Fotokopje e kartës së identitetit;
- c) Certifikatën e vdekjes së dy prindërve;
- d) Fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit të përfituar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

1/ç) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë

- **Rasti kur studenti e ka humbur përgjegjësinë prindërore nga të dy prindërit;**
 1. Certifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- **Vendim gjykatë i formës së prerë që studenti ka humbur përgjegjësinë prindërore (nga të dy prindërit) (Kopje origjinale ose kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës)**

Rasti kur studenti e ka humbur përgjegjësinë prindërore nga njëri prind dhe prindi tjetër nuk jeton

1. Certifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
2. Vendim gjykatë i formës së prerë që studenti ka humbur përgjegjësinë prindërore (nga njëri prind) (Kopje origjinale ose kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës)
3. Certifikatë vdekjeje e prindit tjetër;

1/d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;

- a) Certifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b) Vërtetim nga Ministria e Mirëqenies Sociale ose Ministria e Brendshme që kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;

1/dh) Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes;

- a) Certifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
- b) Certifikatë vdekje e prindit që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- c) Vërtetim konfirmimi nga Ministria përkatëse;

1/e) Studentët romë dhe Ballkano-egjiptianët, konfirmuar si të tillë nga Ministria e Mirëqenies Sociale

- a) Fotokopje e kartës së identitetit;
- b) Vërtetim anëtarësie në shoqatën përkatëse;
- c) Vetedeklarim noterial që vërteton etninë e tyre;

1/ë) Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të

dënuar politikë me heqje lirie;

- a) Certifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- b) Vërtetimi i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
- c) Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

“Studentët aplikojnë për reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimit të kriterëve deri me datën 26.12.2025

DEGA E FINANCES

ADMINISTRATORI